

në Kozjak të Kumanovës (Simo Mladenovski), në rrethinën e Lerinit (Olga Beqarova) dhe në fshatin Bitushe të Gostivarit (Borivoje Xhimrevski).

Në fund jepet diskutimi i zhvilluar në këtë Simpozium, me ç'rast morën pjesë një 19 diskutues, respektivisht janë bërë 31 diskutime.

I pari mori fjalën Zihni Sako, i cili përkitazi me referatin e E. Zakhos-Papazahariut dha ca plotësime për bestytnitë e shqiptarëve lidhur me dragojn, duke theksuar se dragoi nuk bën keq, por mirë. Më pas kemi diskutimin e Igor Sheptunovit e Kole Simitçevit etj.

Diskutimi më i gjallë u bë rreth punimeve të Dragosllav Antonijeviqit dhe Millan Zeçeviqit. Në këto diskutime u bë

fjalë mbi metodën psikoanalitike që ka përdorur Antonijeviq në punimin e tij për zakonet dhe këngët pranverore të blegëtarëve ballkanikë.

Gjithashtu, një pjesë e mirë e diskutimit i është kushtuar anës muzikore të këngëve pranverore. Më saktë është diskutuar pikërisht nëse këto këngë janë krijuar para apo pas ardhjes së turqve në Ballkan. Kjo gjë mund të përcaktohet nga fakti, nëse këngët në vargun e tyre tonik kanë apo s'kanë sekondën e tepruar.

Në fund të revistës është dhënë edhe lista e bashkëpunëtorëve, punimet e të cilëve janë shtypur në këtë numër.

KADRI HALIMI

### MAKEDONSKI FOLKLOR 13, Skopje 1974, f. 258

Ky numër përmban materialet e Simpoziumit III Ndërkombëtar të Folklorit Ballkanik, mbajtur në Ohër më 7 e 8 korrik 1973.

Si rëndom, materiali është ndarë në artikuj, kumtesa, materiale, kritika e recensione, kronikë dhe bibliografi.

Artikujt, gjë e cila është me vend, gjithashtu janë grupësuar, jo sipas autorëve, po sipas natyrës së lëndës, në këto lëmi: 1) Bilinguizmi në krijimtarinë popullore prozaike, 2) Probleme mbi terminologjinë dhe klasifikimin e zhanreve të shkurta, 3) Instrumentet popullore muzikore aerofonike me gjuhën dyjësore (tipi i oboa-s), 4) Pozita dhe roli i gruas në kërcimin e valleve dhe të këngëve popullore, 5) Lulet në ornamentikën popullore ndër popujt ballkanikë, dhe 6) Çështje të ndryshme rreth folkloristikës.

Tre artikujt e parë i janë kushtuar bilinguizmit. Kështu, Emil Sikar (nga Bordoja e Francës) në punimin e tij „*Të folmet*” dhe folklori, „*gjuha*” dhe *njësimi juridik*, pohon se në suazën e kulturës së përgjithshme, në krijimtarinë artistike letrare, qoftë kjo individuale apo kolektive, folklori ndikon dukshëm. Folklori gjithashtu pasuron gjuhën, sidomos në ato bashkësi shtetërore multinacionale. Jozhef Faragó (Kluzh, Romani) punimin e vet e ka titulluar *Mbi proporcionet gjuhësore në repertorin e tregimtarëve bilinguistë të tregimeve*. Hulumtimet e veta autori i ka bërë në një visore, ku jetojnë së bashku rumunët, hungarezët dhe gjermanët. Ky na sjell konstatime interesante. Tregimtari zakonisht njëjshëm dy gjuhë, është i aftë t'i përkthejë tregimet

e gjuhës tjetër në gjuhën e vet amtare apo anasjelltas, kështu që tregimi kallëzohet në dy gjuhë, në dy stile, por me një përmbajtje. Mirëpo, një numër tregimesh s'është në gjendje ta thotë në dy gjuhë, sepse nuk mund t'ua qëllojë onomatopeve, lojës së fjalëve, dialogëve eklatante etj. Nga ana tjetër, ka tregime që kallëzohen gjuhësisht të përziera dhe kështu me radhë. Për ne folkloristët e Kosovës studimi i këtij fenomeni ndër ne do të sillte rezultate të lakmueshme. Duke mbledhur folklor në terren kemi hasur në bilinguizëm jo vetëm në tregime, por edhe në këngë popullore. Këtij fenomeni i është kushtuar edhe artikulli *Dukuritë e bilinguizmit në tregimet maqedone*, i folkloristes Aleksandra Popvasileva. Kjo ka gjetur ca tregime maqedone gjuhësisht të përziera me turqishtën ose me greqishten.

*Klasifikimi i fjalëve të urta prognostike dhe parashenjat për motin ndër sllavët e jugut dhe të perëndimit* është punimi i Bogusllav Beneshit (Bërno, Çekosllovakia). Autori përpiqet t'i klasifikojë dhe t'ua caktojë përkatësinë prognozave meteorologjike popullore, të cilat paraqesin thënie të shkurta që kanë të bëjnë me motin, me stinët etj. A janë këto fjalë të urta, aforizma, alegori, gnomat etj.?

Katër artikujt vijues u janë kushtuar instrumenteve muzikore aerofonike me gjuhës dyjësore. Artikulli i Sotir Golaboski-t, *Prejardhja e zurlës* është mjaft interesant. Autori konkludon se zurla është instrument persian, i ngjashëm me zamrin arab. Zurlen e sollën në Maqedoni turqit.

Ky instrument gjendet i pikturuar në freskat e manastireve të shekujve XII e XIV. Sot e përdorin më tepër romët. *Zurlet, muzika e zurleve te disa popuj balkanikë dhe format relikte të saj*, është artikulli i Ilija Manollov-it (nga Sofja). Së pari ai thekson se një instrument i ngjashëm i quajtur *avlos* dhe *tibia* ka ekzistuar te fiset thrakase në pjesën lindore të Maqedonisë në rrjedhat e lumenjve Mesta dhe Struma. Këtë, më vonë e zëvendësoi *zurla*, të cilat mund të jenë të shkurta, të mesme dhe të gjata. Në vijim, autori flet me përdorimin e këtij instrumenti në trevën folklorike të Pirinit dhe mbi traditën muziko-folklorike të kësaj ane. Më pas, stilin e muzikës së lojtur me *zurle* autori e ndan në dy grupe: 1) melodi të tubimeve dhe të dasmave, valle dhe lojna korale, dhe 2) melodi relikte, të trashëguara nga e kaluara e Ishtë, të ciklit „rusalia” që ka karakter ritual. Amon Shiloah (Jerusalem, Izrael) shkruan mbi *Instrumentet aerofonike me gjuhëz të tipit të obous dhe të klarinetit në Lindjen e Afërme, shtrirja, terminologjia dhe funksioni i tyre*. Ai vë në dukje se në qytetërimet e lashta lindore së pari shfaqet klarineti e më pas oboa. Autori ka dhënë edhe terminologjinë për këto instrumente, e cila është shumë e larmishme. Në fund të këtij grupi artikujsh, zë vend artikulli i Benjamin Kru-tës me titull: *Një instrument polifonik: Culadyjare ose fyelli i dyfishtë shqiptar dhe paralelet e tij ballkanike*. Ky autor tiranas në artikullin e vet së pari jep ca paralele të këtij instrumenti ndër popuj ballkanikë, e të tjerë. Kështu si pandan të këtij instrumenti, do të thotë të *culadyjares*, cek „dvojnicën” e serbëve dhe të kroatëve, „dvojan-kën” e maqedonëve dhe të bullgarëve, „dvojnistalen” e sllovakëve, „fluer gemanat” e rumunëve. Më pas jep shtrirjen e këtij instrumenti në Shqipëri, përshkrimin detal, duke sjellë fotose dhe vizatime si dhe ca melodi që ekzekutohen me këtë instrument muzikor. Në vijim shkruan se ky instrument mund të gjendet i paraqitur në monumente antike të Greqisë dhe të Egjiptit. Gjithashtu edhe në Ilirinë Jugore ka qenë në përdorim ky instrument. Kështu, në Apoloni janë zbuluar dy relieve në të cilat është paraqitur ky instrument. Njëri është nga shekulli VI—V dhe tjetri III—II para erës sonë. Në fund pohon se *culadyjare* është, sipas strukturës dhe karakteristikave të veta, instrument tipik pastoral, barinjsh.

Në vijim pasojnë dy artikuj mbi pozitën dhe rolin e gruas në ekzekutimin e valleve dhe të këngëve popullore. Erno Pesovar shkruan për *Vallet arkaike të dyshave në*

*Evropën Juglindore*. Ai thotë se në Basenin e Karpateve dhe në Ballkan ekzistojnë tipe vallesh të dyshave, shumë arkaike, të cilat ndihmojnë shumë në studimin e zhvillimit të artit të këtij lloji. Pohon se këto valle (lojna) janë agresive, luftarake dhe kanë karakter paralirik, u prijnë valleve me dyshe të dashurisë. Autori i dytë, poashtu nga Budapesti, Gjergj Martin bën fjalë për *Ndikimin ballkanik në vallen hungareze të grave*. Këtë ndikim e dëshmojnë, sikundër thotë autori, edhe vetë emërtimet e valleve të ndryshme. Më pas, autori përshkruan këto valle si dhe mënyrën e luajtjes së tyre, duke gjetur paralele me vallet e sllavëve të jugut.

Grupi vijues i artikujve është ai që ka për objekt lulet në ornamentikën popullore të popujve ballkanikë. Në këtë tog artikujsh gjejmë tri punime: Gjorgji Zdravev, *Lulet në ornamentikën popullore maqedone të tekstilit*. Në treva të ndryshme qendisen lule të ndryshme të stilizuara apo reale. Niko P. Tozi, shkruan për *Lulet në punimet e drugdhendësve të Miakut*. Shkolla e drugdhendësve të Dibrës është e shquar. Ky artizanat ka një traditë shumë të gjatë. Megjithëse ka pasur ndikime nga Atosi, Selaniku dhe Durrësi, prapëseprapë drugdhendësit e Miakut, të gjitha ndikimet i kanë sintetizuar dhe i kanë dhënë një vull të vetën, duke krijuar një stil të veçantë. Këta mjeshtër kanë lënë vepra të bukura në drugdhendje nëpër kisha e manastire të ndryshme. Të shumtën janë skalitur hardhia dhe akanti dhe shpeshherë figura njerëzish dhe zogjesh të ndryshëm. Këta mjeshtër kanë punuar edhe nëpër ndërtesa private. Vasile Adaskalicej (Jashi) në punimin e tij *Lulet në pikturën murale të fshatit ndër rumunë, polakë dhe hungarezë*, flet për dukurinë e pikturimit të shtëpive fshatare në disa vise të këtyre tri shteteve. Autori në këto piktura gjen gjëra të përbashkëta dhe të veçanta. Ai ka sjellë mjaft material ilustrativ.

Në togun e punimeve rreth çështjeve të ndryshme folkloristike, gjejmë gjashtë punime. Punimet janë me tematikë të ndryshme: Suzan Cigler (Berlin), *Figurat e përsëritshme në muzikën dhe tekstin e këngëve maqedone*; Katarina P. Podollakova (Bratisllava), *Determinantet e ndryshimit të folklorit në kushtet e shoqërisë socialiste*. Ky artikull është mjaft interesant, sepse shtjellon një temë aktuale. Si shembull autorja ka marrë Sllovakinë. Ajo thotë se faktorët kryesorë, që ndikojnë në krijimtarinë e re folkloristike, janë industrializimi dhe revolucioni kulturor, bashkë me mjetet e komunikimit masiv. S. I. Bruk —

— K. V., Çistov, (Moskva), *Probleme bashkëkohëse të folkloristikës sovjetike*. Problemet e folkloristikës sovjetike, sipas autorëve dalin nga këta faktorë kryesorë: 1) ndërliqshmëria e përbërjes etnike e BRSS, 2) funksioni internacional i folkloristikës sovjetike dhe 3) transformimi social dhe kulturor i shoqërisë sovjetike. Në vijim kemi edhe tri punime: Juzef Burshta (Poznanj), *Studimet polake të folklorit ballkanik — të Oskar Kolbergut dhe Kazhimjezh Moshinjskit*; V. K. Bondarçik — A. S. Fedosik (Minsk), *Bazat shkencore të botimit shumëvëllimësh të folklorit belorus*; Ksenija Siharulidze (Tbilisi), *Studimi krahasues i poezisë agrare gruziane*.

Në rubrikën „Kumtesa” jepen tetë kumtesa të shkurta rreth temash të ndryshme, ekskluzivisht të folklorit maqedon, madje prej autorësh të vendit, maqedonë. Këto kumtesa shqyrtojnë tema të ndryshme: *Balada maqedone sot*, *Përmbajtja e këngës maqedone gjatë tri gjeneratave*, *Folklori në veprat e Vasil Iloskit, Kraj*

*Marku humb fuqinë, Profeti Jeremia në traditën popullore, Kallëzime të mbledhura prej Marko Cepenkov, Doket dhe lojnat rusale në fshatin Sekirnik, Karakteristikat muzikore të këngëve të kremtës Vodice në Poreç*.

Në rubrikën „Materiale” kemi dy kontribute të vogla: *Bërja e martinës* (një lloj nuske) dhe *Këngët llazore të Drimkollit*. Në këtë të fundit jepet një numër i madh këngësh interesante. Pas rubrikës „Kritika, recensione dhe shënime”, brenda së cilës jepen 25 kritika e recensione për vepra dhe revista të ndryshme të vendit dhe nga jashtë, kemi kronikën e ngjarjeve, të tubimeve folkloristike dhe etnografike dhe, në fund, bibliografinë.

Padyshim që edhe ky numër i kësaj reviste na jep të kuptojmë se në RS të Maqedonisë po i kushtohet kujdes i madh folklorit, krijimtarisë popullore të maqedonëve.

**KADRI HALIMI**

**NARODNA KNJIŽEVNOST** (izbor studija i članaka o narodnoj književnosti) priredili: Dr. Đenana Buturović i Dr. Vljako Palavestra, „Svjetlost”, Sarajevo 1974, f. 286.

Në këtë përmbledhje studimesh dhe artikujsh mbi letërsinë gojore të regjionit të të folurit sërbo-kroatish, përpiluesit Dr. Gjenana Buturović dhe Dr. Vljako Palavestra kanë përfshirë 31 punime të 23 autorëve. Vëllimin — LETËRSIA GOJORE e kanë ndarë në dy pjesë: Poezia popullore (24 punime) dhe proza popullore (7 punime). Janë këto studime, artikuj, vështrime, punime me karakter informativ-shpjegues dhe asish me elemente të recensimit.

Në parathënien e shkurtë përpiluesit pohojnë, pos të tjerash, se qëllimi i tyre ka qenë të prezantojnë ato punime mbi letërsinë gojore (autorët herë përdorin termin letërsi popullore e herë letërsi gojore) të regjionit të të folurit sërbo-kroatish (sërbëve, kroatëve, muslimanëve dhe malazezëve), që paraqesin shkallën e arritur në punën shkencore-hulumtuese, përfundimet e të cilave punime, në një mënyrë ose në një tjetër, i kanë pranuar shumica e hulumtuesve, sidomos sa i përket bazës së tyre teorike. Në qoftë se mbështetemi në këtë dhe në të dhëna të tjera, si dhe në vetë punimet e botuara, mund të thuhet, në pika të përgjithshme, sa vijon:

1. Duke i parashtruar vetes si detyrë të përfshijnë në përmbledhje artikuj, që

bëjnë fjalë kryesisht për traditën letrare gojore që krijohet te sërbët, te kroatët, te muslimanët dhe te malazetët, përpiluesit kanë qenë të detyruar të lënë anash disa artikuj analitikë, që bëjnë fjalë për probleme të përgjithshme të krijimtarisë letrare gojore të popujve që jetojnë në Jugosllavi, me një anë, dhe, duke dashur herë-herë të përgjithësojnë traditën letrare të regjionit të të folurit sërbo-kroatish, kanë përfshirë artikuj, ku bëhet fjalë dhe për letërsinë gojore jugosllave, dmth. është përfshirë letërsia gojore sllovene, maqedone dhe ajo që krijohet në Vojvodinë, sikur është rasti me punimin e V. Nediqit për lirikën popullore jugosllave, ai i Vido Llatkoviçit mbi klasifikimin e letërsisë gojore jugosllave, në anën tjetër.

2. Disproporcioni sasior i artikujve, që bëjnë fjalë për poezinë dhe për prozën gojore (edhe pse përpiluesit e arsyejnë me të dhënën se s'ka artikuj të mjaftë mbi prozën), është i paarsyeshëm. Ndonëse numerikisht ka më shumë artikuj mbi poezinë gojore, prapëseprapë ka pasur mundësi të zgjedhen edhe disa artikuj të tjerë mbi aspektet dhe llojet e ndryshme të prozës gojore. Për një gjë të tillë bindemi në qoftë se e shfletojmë librin „Bibliografija radova o narodnoj književnosti”, autorë: M.